

VENDIM
Nr.639, datë 18.9.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE
MËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për përcaktimin e pagave të punës”, me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, lidhjet nr.1 “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë” dhe nr.2 zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Efektet financiare, për vitin 2003, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga Buxheti i Shtetit i vitit 2003, i parashikuar për rritjen e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16 shtator 2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA NR.1

EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
	PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E PROFESIONIT	
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion	Totali
Drejtor i shkollës së mesme Përgjegjës poligoni Dr. Inst. Nxën. që nuk shikojnë Dr. Inst. Nxë. që nuk dëgjojnë Dr. në shkollat me PLM Drejtor i konvinteve	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	14420	Nga...lekë Deri...lekë
Zv/Dr. në shkollë të mesme Zv/Dr. në inst. e nxën. që nuk shikojnë e dëgjojnë dhe shkollat me PLM Dr. Qendrës Kulturore të fëmijëve Përgjegjës i bazës prodhuese	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	12020	Nga...lekë Deri...lekë
Drejtor i shkollës tetëvjeçare	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	11660	Nga...lekë Deri...lekë
Drejtor i shkollës fillore (klasa I-IV).Përgjegjës (Kryemësuesi) i shkollës me klasë kolektive. Zv/Dr i shkollës 8-vjeçare. Përgjegjës	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	10100	Nga...lekë Deri...lekë

sektori në Qendrën Kulturore të fëmijëve					
Drejtor i kopshtit me ushqim	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	8640	Nga...lekë Deri...lekë
Drejtor i kopshtit pa ushqim	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	7130	Nga...lekë Deri...lekë
Mësues në shkollat e mesme Mësues në inst. e nxën. që nuk shikojnë e nuk dëgjojnë dhe në shkollat me PLM.	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	10200	Nga...lekë Deri...lekë
Mësues në shkollat 8-vjeçare (I-VIII). Eduktor konvikti. Kujdestar konvikti. Instruktor në Qendrën Kulturore të fëmijëve	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	8200	Nga...lekë Deri...lekë
Edukatore në kopësht fëmijësh.	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	6050	Nga...lekë Deri...lekë
Mësues	2	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	7890	Nga...lekë Deri...lekë
Mësues	3	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	7890	Nga...lekë Deri...lekë
Edukatore në kopësht fëmijësh	3	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	6510	Nga...lekë Deri...lekë
Edukatore në kopësht fëmijësh	2	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	6510	Nga...lekë Deri...lekë

LIDHJA NR.2

GRUPI	PAGA NË LEKË
1	8750
2	6930
2	6265
4	4160